



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM**

**Nr. i Dokumentit: 22.18.1-2013-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT**  
**PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMUNËS SË GJILANIT**  
**PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2013**

**Prishtinë, Qershor 2014**

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm, Lage Olofsson, është kreu i ZAP-it, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe ZAP janë të pavarur dhe çertifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, ndërsa mund të ndërmarr edhe forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga ZAP promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për t'i kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Gjilanit në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Florim Beqiri, i mbështetur nga, Mehmet Muçaj (Udhëheqës Ekipi), Evetar Zeqiri dhe Qëndresa Sogojeva.

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme .....	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia .....	7
2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm .....	8
3 Rekomandimet e vitit paraprak .....	13
4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli .....	14
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP .....	28
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak.....	31

## Përmbledhje e përgjithshme

### Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare të komunës së Gjilanit për vitin 2013 - i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Falënderoj Kryetarin e Komunës dhe ekipin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2013 u ndërmorr në përputhje me Standardet e njohura Ndërkombëtare të Auditimit në Sektorit Publik. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me Pasqyrat Vjetore Financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, të datës 04.10.2013.

Auditimi ynë është fokusuar në:

- Pajtueshmërinë me kornizën e raportimi dhe rreziqet domethënëse për Pasqyrat Vjetore Financiare të theksuara në Memon e Planifikimit të Auditimit;
- Reagimin ndaj rekomandimeve tona për vitin 2012 dhe atyre të mëhershme; dhe
- Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm të Komunës (duke përfshirë menaxhimin dhe ekzekutimin e buxhetit dhe Auditimin e Brendshëm).

Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2013 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

## Opinion

Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyra e Auditorit të Përgjithshëm.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm është:

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare *prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë*, në të gjitha aspektet materiale.

Si *Theksim i çështjes* Regjistri i Pasurive Fikse ende nuk është i plotë dhe i saktë për arsye se 3,701,615€ objekte shkollore të komunës nuk ishin regjistruar në regjistrin kontabël dhe nuk janë prezantuar në PVF. Po ashtu komuna kishte bërë keq klasifikim të shpenzimeve ku nga kategoria e investimeve kapitale kishte paguar për mallra dhe shërbime vlerën prej 16,245€ dhe për subvencione vlerën prej 2,826€. Regjistri i pasurive fikse dhe keq klasifikimi ekonomik i shpenzimeve nuk ka ndikim në ndonjërin prej dy Pasqyrave Vjetore Financiare ('Pranimet dhe Pagesat në Para të Gatshme' dhe 'Krahasimi i Buxhetit me Shumat Aktuale') në pajtim me SNKSP në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme. **(SNISA 200: Opinion i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes).**

## Konkluzioni i përgjithshëm

Bazuar në detajet e paraqitura në secilën pjesë të këtij raporti, konkluzioni ynë i përgjithshëm është se:

Menaxhmenti i Komunës kishte dizajnuar një sistem efektiv të kontrollit të brendshëm, mirëpo këto kontrole nuk kishin funksionuar në nivel të kënaqshëm në disa fusha të rëndësishme të menaxhimit financiar gjatë gjithë vitit . Sistemi i kontrollit të brendshëm duhet në vazhdimësi të përmirësohet për t'u siguruar se kontrollet funksionojnë siç duhet. Mangësitë kryesore të identifikuara ishin:

- Edhe pse Pasqyrat Vjetore Financiare kishin adresuar shumicën e kërkesave për raportim, pasqyrat e paraqitura për auditim kishin një numër lëshimesh dhe pasaktësish. Disa nga këto gabime janë përmirësuar në versionin final të pasqyrave duke përfshirë vlerat materiale të pagesave nga palët e treta dhe llogaritë e arkëtueshme. Megjithatë, Pasqyrat Vjetore Financiare ende përmbajnë disa gabime rreth plotësisë dhe saktësisë lidhur me regjistrin e pasurisë;
- Rekomandimet e vitit 2012 dhe të viteve të mëparshme nuk janë implementuar ende. Kjo ka rezultuar në kontrole të dobëta në fushat si menaxhimi i pasurisë, procesi i prokurimit, përfshirë pagesat për organet mbikëqyrëse për projekte kapitale; dhe
- Edhe pse ne arritëm të merrnim siguri nga kontrollet efektive të menaxhmentit në disa fusha të pasqyrave, në disa fusha tjera të rëndësishme të veprimtarisë ekzistojnë dobësi domethënëse. Kjo veçanërisht ka ndodhur në prokurim, ku kontratat janë

menaxhuar dobët ka rezultuar me vonesa në kryerjen e punëve dhe rritje të vazhdueshme të obligimeve.

### **Rekomandimet tona kryesore për Kryetarin e Komunës janë si në vijim:**

- Të identifikoj arsyet për pasaktësitë fillestare lidhur me: a) Vlerën e pasurive; b) Raportimin e të gjitha obligimeve; dhe c) dështimit për të ndjekur këshillat e Auditorit të Përgjithshëm për të adresuar këtë. Procesi të duhura duhet të vendosen në vitin 2014 për të siguruar prezantim të saktë të aseteve në Pasqyrat Vjetore Financiare;
- Të sigurojë që në procesin e hartimit të Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2014 të përfshihet formalisht edhe rishikimi nga menaxhmenti i draft pasqyrave, me fokus të veçantë në fushat që konsiderohen me rrezik të lartë për gabime dhe/ose fushat ku gabimet janë identifikuar në vitet e mëparshme (duke përfshirë pagesat nga palët e treta, llogaritë e arkëtueshme dhe vlerën e pasurisë);
- Të sigurojë që plani i veprimit, i rishikuar, të përcaktojë saktë afatet kohore që janë njëkohësisht të zbatueshme dhe sfiduese për adresimin e rekomandimeve të bëra nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme;
- Të kryejë një vlerësim të detajuar të procesit të Prokurimit dhe kontrollit për të kuptuar se pse dobësitë e identifikuar vazhdojnë të shfaqen, dhe të identifikojë veprimet që duhen zbatuar për t'i mënjeluar pengesat për implementimin e kontrolleve në mënyrë efektive;
- Të siguroj që plani i punës së NJAB-it i aprovuar nga menaxhmenti të jetë i fokusuar në periudhën e vitit aktual për të ofruar siguri për menaxhmentin që sistemet e brendshme janë funksionale;
- Të siguroj se ekzistojnë kontrolle të duhura për shpenzimet e drekave zyrtare të mbështetura me dëshmi të duhura dhe të mjaftueshme për të demonstruar qëllimin dhe koston e këtyre organizimeve; dhe
- Të rishikoj çështjen obligimeve të pa paguara duke diskutuar me të gjitha nivelet (MF-në dhe Qeverinë) si dhe të krijoj një strategji adekuate për të menaxhuar dhe mbajtur nën kontroll obligimet.

### **Përgjigja e Menaxhmentit - auditimi për vitin 2013**

Menaxhmenti është pajtuar me të gjitha të gjeturat e auditimit dhe është zotuar se do t'i adresoj rekomandimet tona.

# 1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e Komunës të përgatis PVF sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” dhe kërkesave të tjera specifike. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave vjetore financiare (PVF) dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e opinioneve:

- Nëse PVF japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar shkallën deri në të cilën mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale gjatë përcaktimit të testimit të hollësishëm, të cilat janë të nevojshme për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmive për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP) dhe fokusin e auditimit tonë të pajtueshmërisë.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato janë konsideruar relevante. Gjetjet tona janë definuar si:

**Të prioritetit të lartë** – Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

**Të prioritetit të mesëm** - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe procedurat vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar. Të gjeturat që konsiderohen si me prioritet të ulët, do t'i raportohen veçmas stafit të financave.

## 2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

### **Konkluzioni i përgjithshëm**

Rishikimi ynë i PVF merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të regjistruar në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Disa deklaratë kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.



## 2.1 Opinioni i Auditimit

### *Opinion i Pamodifikuar<sup>1</sup> me Theksim të Çështjes*

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë, në të gjitha aspektet materiale.

Si *Theksim i çështjes* Regjistri i Pasurive Fikse ende nuk është i plotë dhe i saktë për arsye se 3,701,615€ objekte shkollore të komunës nuk ishin regjistruar në regjistrin kontabël dhe nuk janë prezantuar në PVF. Po ashtu komuna kishte bërë keq klasifikim të shpenzimeve ku nga kategoria e investimeve kapitale kishte paguar për mallra dhe shërbime vlerën prej 16,245€, dhe për subvencione vlerën prej 2,826€. Regjistri i pasurive fikse dhe keq klasifikimi ekonomik i shpenzimeve nuk ka ndikim në ndonjërin prej dy Pasqyrave Vjetore Financiare ('Pranimet dhe Pagesat në Para të Gatshme' dhe 'Krahasimi i Buxhetit me Shumat Aktuale') në pajtim me SNKSP në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme. **(SNISA 200: Opinioni i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes).**

---

<sup>1</sup>Termi "Opinion i Pamodifikuar" është ekuivalent me termin "opinion i pakualifikuar" i përdorur në versionin paraprak të Raportit Vjetor. Terminologjia e re është në pajtim me standardet e reja të INTOSAI-t (SNISA 200). Për më tutje referohuni në shtojcën I.

---

## 2.2 Rreziqet domethënëse në Pasqyrat Vjetore Financiare

### Përshkrimi

Në Memon tonë të planifikimit të auditimit, e datës 04.10.2013, janë identifikuar 3 rreziqe domethënëse në PVF-të: lidhur me plotësinë e pasurive, pagesat nga palët e treta dhe mungesa e softuerit për faturim.

Këto janë rreziqe të anomalive materiale, nga të cilat mund të rezultojë një opinion i modifikuar, përfshirë Theksimin e Çështjes.

Rreziqet e anomalive materiale që ne kemi identifikuar në lidhje me mungesën e softuerit të faturimit nuk është materializuar sepse ishin vendosur kontrolle të menaxhmentit në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme. Rreziqet tjera të identifikuara ishin materializuar si më poshtë:

### Rreziku i identifikuar

#### Çështja 1. Pagesat nga palët e treta jo të plota në PVF

##### E gjetura

Gjatë auditimit të ndërmjetëm ne kemi shqyrtuar kontrollet e menaxhmentit dhe proceset shoqëruese për të siguruar prezantim të saktë të pagesave nga palët e treta në PVF si dhe kemi dhënë këshilla për t'i përmirësuar ato ashtu siç duhet. Përkundër kësaj, rreziqet e identifikuara janë materializuar, ngase menaxhmenti kishte dështuar për t'i zbatuar përmirësimet e sugjeruara dhe pagesat nga palët e treta ishin materialisht të pasakta. Komuna kishte përmirësuar vlerat për pagesat nga palët e treta në PVF-të finale bazuar në gabimet që ne kemi identifikuar.

**Rekomandimi 1 Prioritet i lartë** –Kryetari duhet të analizoj arsyet për keq deklarimet materiale lidhur me pagesat nga palët e treta dhe dështimi për të ndjekur këshillat e ZAP-it për të siguruar prezantim të saktë të këtyre pagesave.

### Rreziku i identifikuar

#### Çështja 2. Pasuritë e komunës nuk ishin regjistruar në mënyrën e plotë dhe të saktë në PVF.

##### E gjetura

Ne vlerësuam kontrollet e zbatuara nga menaxhmenti për ta dëshmuar plotësinë e regjistrave të pasurive bazuar në shpenzimet kapitale për vitin 2013 dhe vitet paraprahe. Në memon e auditimit të ndërmjetëm, ne i kemi dhënë këshilla menaxhmentit për veprimin që nevojitet për të siguruar që vlera e pasurive në PVF është e saktë. Megjithatë, rreziku i

identifikuar është materializuar, sepse Menaxhmenti nuk ka arritur të zbatoj përmirësimet e nevojshme dhe ne kemi konfirmuar që vlerat e pasurive të regjistruara në PVF janë të pasakta për faktin se 3,701,615€ për objekte shkollore nuk ishin regjistruar në regjistrat e pasurisë. Këto pasuri të vlerësuara nga komisioni për vlerësim kishin të bënin me tri objekte shkollore.

**Rekomandimi 2 Prioritet i lartë** –Kryetari duhet të identifikojë arsyet për keq deklarimin fillestar të pasurive dhe dështimin për ndjekur këshillat e ZAP-it. Procesi të duhura duhet të vendosen në vitin 2014 për të siguruar prezantim të saktë të pasurive në PVF.

## 2.3 Pajtueshmëria me kërkesat për raportim në PVF

### Përshkrimi

PVF duhet të jenë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me RrF nr. 03/2013;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048;
- PVF janë përgatitur brenda kornizës kohore dhe janë dorëzuar në MF;
- PVF janë nënshkruar nga ZKA (Kryetari i Komunës) dhe ZKF;
- PVF janë pranuar në gjuhën shqipe dhe serbe;
- PVF janë përgatitur në kopje fizike dhe elektronike; dhe
- Komuna kishte përgatitur dhe dorëzuar raporte të rregullta tremujore tek Kuvendi Komunal dhe një kopje tek Ministri i MF gjatë vitit 2013.

Nuk kemi asnjë çështje për të ngritur në lidhje me plotësimin e kërkesave të mësipërme. Megjithatë, PVF-të fillestare kanë përmbajtur disa gabime. Ne gjatë procesit të auditimit kemi dhënë sugjerime për korrigjimet e duhura. Vlerat për pagesat nga palët e treta dhe vlera e llogarive të arkëtueshme të cekura më lartë, janë korrigjuar. Këto të fundit, dhe gabimet e pa përmirësuara janë sqaruar më poshtë:

### Çështja 3. Procesi i përgatitjes së Pasqyrave - Prioritet i lartë

**E gjetura** Shënimi 30 Përmbledhja e pasurive jo-financiare kapitale mbi 1,000€ ishte e nënvlerësuar për 3,701,615€.

Po ashtu, komuna kishte keq klasifikuar shpenzime në vlerë 19,071€. Nga kodi i kapitaleve, komuna kishte bërë pagesa për subvencione (2,826€), dhe mallra dhe shërbime (16,245€).

**Rreziku** Paraqitja jo e saktë e PVF dhe gabimeve të identifikuara në shumat e regjistruara shpie në një keqkuptim të pozitës financiare të komunës dhe ka ndikim potencial negativ në saktësinë e kërkesave të ardhshme buxhetore.

**Rekomandimi 3** Kryetari duhet të sigurojë që kërkesa nga plani i hartimit të PVF 2014 për rishikimin e draft llogarisë nga menaxhmenti zbatohet me fokus të veçantë në fushat që konsiderohen me rrezik të lartë të gabimit. Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF lidhur me saktësinë e PVF-ve nuk duhet të dorëzohet pa u siguruar se janë zbatuar të gjitha kontrollet relevante për PVF-të.

## 2.4 Pajtueshmëria me kërkesat e tjera për raportim të jashtëm

### Përshkrim

Komuna kishte adresuar obligimet për raportim të jashtëm si në vijim:

- Kërkesa Buxhetore për financim të projekteve kapitale në Ministrinë e Financave (MF);
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore me kohë;
- Raportet operative (performancës);
- Raportin e vetëvlerësimit;
- Draft plani i prokurimit me kohë;
- Raportet mbi borxhet të dorëzuara në MF; dhe
- Plani i Veprimit për implementimin e rekomandimeve.

### Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

---

## 3 Rekomandimet e vitit paraprak

### Konkluzioni i përgjithshëm

Menaxhmenti i komunës nuk ishte marrë seriozisht me adresimin e rekomandimeve të dhëna në vitin e kaluar dhe kjo ka shkaktuar që të njëjtat rekomandime të përsëriten edhe në këtë vit.

### Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit për PVF-të të vitit 2012 të Komunës kishte rezultuar me 18 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të adresohen të gjitha rekomandimet.

Deri në fund të auditimit, katër rekomandime janë adresuar plotësisht; shtatë janë adresuar pjesërisht, dhe shtatë nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën II.

---

#### Çështja 4. Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak – Prioritet i lartë

**E gjetura** Vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar janë adresuar sepse komuna nuk ka zbatuar ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e adresimit të rekomandimeve të ZAP-it.

**Rreziku** Disa nga dobësitë e njëjta vazhdojnë të përsëriten në sistemet financiare kyçe, si Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli të cilat kanë rezultuar në:

- Mungesë të një strategjie efektive që do të adresonte nivelin e lartë të të arkëtueshmeve;
- Vazhdimin e pagesave me 1% të vlerës së kontratës për organet mbikëqyrëse;
- Vonesa kohore në realizimin e projekteve (kryerjen e punimeve); dhe
- Dhënia e subvencioneve duke mos respektuar rregulloren e brendshme komunale.

**Rekomandimi 4** Kryetari i Komunës duhet të siguroj se një plan i rishikuar, praktik njëkohësisht edhe sfidues, është hartuar për të adresuar rekomandimet e bëra nga Auditori Përgjithshëm, duke caktuar stafin përgjegjës me një fokus fillestar në fushat më të rëndësishme. Zbatimi i këtij plani duhet të rishikohet nga kryetari në baza mujore.

## 4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

### 4.1 Konkluzioni i përgjithshëm

Qasja jonë e auditimit është fokusuar në të kuptuarit dhe vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv dhe rezultateve nga këto veprime. Për sisteme individuale financiare, ne kërkojmë të identifikojmë nivelin në të cilin operojnë kontrollet aktuale. Ne konsiderojmë se kontrollet janë të dizajnuara mirë, por nuk po zbatohen në praktikë dhe nuk ishin aq sa duhet funksionale. Kjo kërkon një vlerësim të strukturave, proceseve dhe linjave e llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti, duke përfshirë rolin e ndërmarrë nga Auditimi i Brendshëm dhe Komiteti i Auditimit.

Ne gjithashtu kemi marrë në konsideratë vetë-vlerësimin e Komunës të ndërmarrë në kuadër të MFP në aspekt të vlerësimit të PEFA dhe vetë-vlerësimin e KBFP.

Ne kemi gjetur se kontrollet mbi procesin e planifikimit të të hyrave nuk janë të mira dhe nuk janë analizuar në mënyrë të qëndrueshme. Kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm në mënyrë që të parandalojë që komuna të ketë humbje financiare, vlerë të dobët për paranë dhe menaxhim jo efektiv të projekteve. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë Prokurimi (mbikëqyrja e projekteve), planifikimi i të hyrave, subvencionet, menaxhimi i pasurisë dhe Auditimi i Brendshëm .

## 4.2 Qeverisja e mirë

### Përshkrim

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuar.

---

### Çështja 5. Dobësi në kontrollet e menaxhmentit të lartë- Prioritet i lartë

- E gjetura** Auditimi i vitit 2013 ka identifikuar dobësi në kontrolle në të gjitha kategoritë ekonomike, veçanërisht në periudhën e fund vitit. Këto dobësi nuk ishin identifikuar në mënyrë efektive përmes mbikëqyrjes së brendshme dhe raportuar tek menaxhmenti apo ku ato ishin identifikuar, nuk ishin marrë veprimet e duhura.
- Rreziku** Dobësitë në funksionimin e kontrolleve menaxheriale në sistemin financiar dhe koncentrimi i shpenzimeve në fund vit, reduktojnë aftësitë e menaxhmentit për të menaxhuar në mënyrë aktive aktivitetet e komunës dhe redukton kontrollin efektiv buxhetor.
- Rekomandimi 5** Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se një strukturë e përshtatshme qeverisëse është zbatuar përmes së cilës menaxhmenti i lartë është i informuar për mangësitë e kontrollit dhe në mënyrë aktive i menaxhon ato.

## 4.3 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

### Përshkrimi

Ne kemi shqyrtuar burimin e fondeve buxhetore për komunën dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike si dhe të hyrat e inkasuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – shpenzimi ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>2</sup>	2013 Shpenzimi	2012 Shpenzimi	2011 Shpenzimi i
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>18,418,682</b>	<b>21,356,768</b>	<b>20,622,791</b>	<b>18,760,946</b>	<b>19,247,706</b>
Granti i Qeverisë - Buxheti	14,818,682	17,436,682	17,413,561	15,319,536	15,605,348
Të bartura nga viti paraprak <sup>3</sup>	0	213,605	213,570	402,198	436,660
Të hyrat vetanake <sup>4</sup>	3,600,000	3,600,000	2,912,076	2,966,741	3,145,344
Donacionet e brendshme	0	38,671	36,540	18,481	12,870
Donacionet e jashtme	0	67,810	47,044	53,990	47,484

Buxheti final, krahasuar me buxhetin fillestar, është më i lartë për 2,938,086€. Kjo rritje është rezultat i vendimeve të Qeverisë për rritje të buxhetit për 1,500,000€, buxhetit me rishikim për 1,118,000€ që është reflektuar në të gjitha kategoritë e shpenzimeve (shih tabelën e mëposhtme), donacioneve vendore dhe të jashtme për 106,481€ dhe të hyrave të bartura nga viti paraprak në shumë prej 213,605€.

Në vitin 2013, Komuna kishte shpenzuar 97% të buxhetit, krahasuar me 98% të vitit 2012. Në përgjithësi, shpenzimi i buxhetit në këtë masë mbetet i kënaqshëm me përjashtim të investimeve kapitale që janë shpenzuar 10% më pak se plani buxhetor. Tabela 2 më poshtë shpjegon më detajisht këto ndryshime.

<sup>2</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

<sup>3</sup> Të hyrat vetanake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

<sup>4</sup> Të hyrat komunale të planifikuara dhe të mbledhura në vitin aktual që është përdorur nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.



**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- shpenzimi ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2013 Shpenzimi	2012 Shpenzimi	2011 Shpenzimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>18,418,682</b>	<b>21,356,768</b>	<b>20,622,791</b>	<b>18,760,946</b>	<b>19,247,707</b>
Pagat dhe Mëditjet	11,529,100	11,619,068	11,594,926	11,508,281	11,084,916
Mallrat dhe Shërbimet	2,804,920	3,227,704	3,128,543	2,546,755	2,102,812
Shërbimet komunale	481,579	531,580	466,999	380,099	399,522
Subvencionet dhe Transferet	562,500	643,557	606,158	283,372	270,195
Investimet Kapitale	3,040,583	5,334,859	4,826,165	4,042,439	5,390,262

**Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:**

- Rritja e buxhetit për Paga dhe Mëditje për 89,968€ dhe Mallra dhe Shërbime për 422,784€ është planifikuar si rezultat i obligimeve të shumta që kishte komuna në këto fusha;
- Buxheti për shërbimet komunale ishte rritur me 50,000€. Rritja në buxhetin e kësaj kategorie ishte bërë për shlyerjen e obligimeve komunale;
- Rritja e buxhetit për investime kapitale në shumë prej 2,294,276€ ishte ndarë nga qeveria me qëllim që të mbështesë komunën për mbulimin e nivelit të lartë të obligimeve të papaguara në kategorinë e investimeve kapitale dhe për të siguruar vazhdimësi të investimeve në vitin vijues; dhe
- Asnjë vit të hyrat vetjake nuk shpenzohen në tërësi, si rezultat direkt i mos ekzekutimit të buxhetit, duke patur parasysh se të hyrat vetjake janë burimi i fundit financiar i përdorur. Në vitin 2014 vlera e bartur e të hyrave ka qenë 377,000€.

**Tabela 3. Të hyrat vetjake komunale të buxhetuara dhe të mbledhura në 2013 (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2013 Pranimi	2012 Pranimi	2011 Pranimi
Të hyrat vetanake	3,600,000	3,600,000	3,289,103	3,177,030	3,524,800

Të hyrat vetanake prej 3,125,647€ ishin shpenzuar si në vijim: për Paga dhe Mëditje 169,155€; Mallra dhe Shërbime 1,605,086€; Subvencione 451,793€ dhe Investime Kapitale 899,613€. Niveli më i ultë i të hyrave krahasuar me planifikimin mund të ndikoj që projektet e planifikuara nga të hyrat vetjake të mos kryhen.

Buxheti fillestar për të hyrat vetjake nuk pasqyronte pranimet e vitit të kaluar dhe faktorët e tjerë relevant. Nga tabela shihet se realizimi i të hyrave ishte 91%.

Në anën tjetër, listat e debitorëve ndaj komunës kanë kaluar shifrën prej 9.7 milion euro, që paraqet një shumë domethënëse për komunën dhe gjendja e llogarive të arkëtueshme është në rritje të vazhdueshme.

## 4.4 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetanake)

### Përshkrimi

Të hyrat e mbledhura në vitin 2013 ishin 3,289,103€ apo mbi 91% të shumës së planifikuar. Këto të hyra janë mbledhur nga tatimi në pronë, lejet e ndërtimit, taksat vjetore të biznesit etj.

---

### Çështja 6. - Të hyrat nga lejet e ndërtimit- Prioritet i lartë

**E gjetura** Komuna nga lejet e ndërtimit për vitin 2013 kishte realizuar të hyra në vlerë prej 514,793€ (planifikimi i të hyrave për leje të ndërtimit ishte 685,000€). Gjatë auditimit kemi identifikuar dukurinë që kompanitë kishin filluar me ndërtimin e objekteve dhe më vonë kishin bërë kërkesën për leje ndërtim. Po ashtu, në të gjitha rastet e testuara, komuna nuk kishte lëshuar asnjë çertifikatë të përdorimit të objekteve.

**Rreziku** Dështimi për të kontrolluar aktivitetet e ndërtimit dhe mbledhjes së të hyrave me kohë do të zvogëlojë të hyrat e komunës, duke kufizuar mundësitë për komunën për të përmbushur aktivitetet e planifikuara. Ndërtimi i objekteve pa kërkuar leje nga komuna rritë rrezikun që të hyrat të mos mblihen në periudhën përkatëse dhe degradon planin urbanistik. Po ashtu, kjo ndikon në bilancet e përgjithshme të komunës, me ndikimin final që projektet e planifikuara nga ky burim të dështojnë të realizohen.

**Rekomandimi 6** Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që aktivitetet e ndërtimit të monitorohen vazhdimisht në mënyrë që të hyrat e parapara të mblihen në kohë.

## 4.5 Shpenzimet

### 4.5.1 Prokurimi

#### Përshkrimi

Gjatë vitit 2013 për investime kapitale komuna kishte shpenzuar 4,826,165€. Ne kemi testuar 12 lëndë të prokurimit dhe 26 pagesa në këtë kategori.

Auditimi ynë ka identifikuar disa kontrolle në procesin e prokurimit të cilat nuk kishin funksionuar në mënyrë efektive.

Ne kemi verifikuar nëse projektet për investime kapitale kanë qenë të përfshira në Programin për Investime Publike (PIP) dhe në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve. Gjithashtu kemi rishikuar nëse ka ndodhur ndonjë ndryshim gjatë vitit lidhur me projektet e parapara që realizohen gjatë vitit. Nuk ka ndonjë çështje lidhur me këto për të ngritur në këtë raport.

---

#### Çështja 7. Kompensimi i Organeve mbikëqyrëse - Prioritet i lartë

**E gjetura** Komuna ka vazhduar të kompensoj punonjësit e saj të brendshëm në cilësinë e organeve mbikëqyrëse dhe komisionet për pranim teknik pavarësisht rekomandimeve tona të dhëna në vitin e kaluar për ta zgjidhur këtë çështje. Organet mbikëqyrëse janë kompensuar me 1% të shumës së përgjithshme të kontratës. Kontratat e identifikuar në vitin 2013 ishin: "Punë publike-projekte të vogla të infrastrukturës"; "Rregullimi dhe vendosja e semaforëve në qendër të qytetit" dhe "Hapja dhe rregullimi i rrugëve të rendit të tretë".

**Rreziku** Vazhdimi i pagesës së organeve mbikëqyrëse dhe komisioneve për pranim teknik përmes operatorëve ekonomik (OE), paraqet konflikt interesi dhe mund të ndikojë në objektivitetin e tyre gjatë mbikëqyrjes, respektivisht të komprometoj kualitetin e punëve gjatë pranimit teknik. Po ashtu, është në kundërshtim me rregullat e thesarit dhe shfrytëzim jo eficient i fondeve.

**Rekomandimi 7** Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që sa më parë që kjo çështje të ngritet në asamble komunale për të gjetur një zgjidhje të përshtatshme për të mbikëqyrur projektet duke siguruar pavarësinë dhe shmangur konfliktin e mundshëm të interesit.

#### **Çështja 8. Menaxheri i prokurimit si organ mbikëqyrës - Prioritet i lartë**

- E gjetura** Në dy raste menaxheri i prokurimit kishte marrë pjesë si organ mbikëqyrës i projekteve kapitale: tek kontratat “Mirëmbajtja teknike e objekteve komunale” dhe “Ndërtimi i rrugëve lokale”. Menaxheri ishte caktuar në kohën kur nuk ushtronte detyrën e menaxherit, mirëpo ka vazhduar edhe pasi është zgjedhur si menaxher i prokurimit. Edhe ky ishte kompensuar me 1%.
- Rreziku** Pjesëmarrja e menaxherit të prokurimit në mbikëqyrje nuk është ndarje e mirë e detyrave dhe potencialisht mund të cenoj objektivitetin e tij. Kompensimi përmes operatorit ekonomik, përveç që paraqet kërcënim ndaj pavarësisë dhe objektivitetit të tyre është në kundërshtim edhe me LMFP.
- Rekomandimi 8** Kryetari të siguroj se në rastet kur mbikëqyrja bëhet nga punonjësit e komunës, të sigurohet që të ruhet objektiviteti dhe pavarësia e organeve mbikëqyrëse duke caktuar persona të pavarur.

## **Çështja 9. Dhënia e kontratës operatorit ekonomik të pa përgjegjshëm - Prioritet i mesëm**

- E gjetura** Procesi i prokurimit për “Rregullimin dhe hapjen e rrugëve të rendit të tretë në Komunën e Gjilanit” ishte përcjellë me disa parregullsi:
- Ofertuesi “Bejta Commerce” ishte shpallur si i pa përgjegjshëm nga autoriteti kontraktues për mosplotësim të kërkesave të stafit profesional. Ky arsyetim ishte i pa qëndrueshëm sepse ofertuesi kishte ofruar dokumentin e kërkuar.
- Në kuadër të kërkesave teknike, ofertuesit “Bejta Commerce” dhe “Bass Com” (fituesi) kishin paraqitur një pjesë të pajisjeve (eskavator) me të njëjtat dokumente të pronësisë. Në dosje të tenderit nuk kishte ndonjë dëshmi (marrëveshje) për shfrytëzim të këtyre pajisjeve. Përveç kësaj, një sërë dokumentesh tjera të këtyre ofertuesve ishin krejtësisht të njëjta. Autoriteti kontraktues nuk kishte ndërmarrë asnjë masë për t’i sqaruar këto çështje ndonëse kishte indikacione për bashkëveprim nga këta dy ofertues.
- Rreziku** Mungesa e kontrolleve të mjaftueshme dhe masave të ndërmarra për të sqaruar dokumentet nga menaxheri i prokurimit gjatë vlerësimit të ofertave paraqet rrezik të bashkëpunimit të ofertuesve në të njëjtën procedurë të prokurimit. Kjo potencialisht mund të rezultojë me humbje financiar për komunën.
- Rekomandimi 9** Kryetari i Komunës të siguroj një monitorim të shtuar të komisioneve vlerësuese nga menaxheri i prokurimit gjatë vlerësimit të ofertave dhe aty ku vërehen indikacione të bashkëveprimit të ofertuesve, të raportohen tek menaxhmenti i lartë dhe të veprohet konform legjislacionit.

## 4.5.2 Shpenzimet jo përmes prokurimit

### Përshkrim

Komuna në vitin 2013 kishte shpenzuar dreka zyrtare 168,582€, ndërsa në vitin 2012 kishte shpenzuar 77,436€. Mbi 0.8% të shpenzimeve totale të buxhetit ishin shpenzuar për dreka zyrtare, që paraqet një shumë jashtëzakonisht të lartë.

---

### Çështja 10. Shpenzimet për dreka zyrtare - Prioriteti i mesëm

**E gjetura** Si pasojë e mos mbulueshmërisë me legjislacion të qartë, janë bërë shpenzime enorme për dreka zyrtare. Për më tepër, mungonin dëshmitë e plota për numrin e pjesëmarrësve apo qëllimin e organizimit. Është i çuditshëm fakti se 91,146€ janë shpenzuar më tepër krahasuar me vitin e kaluar.

**Rreziku** Mungesa e dëshmive të mjaftueshme, arsyet dhe se nga çfarë niveli janë shpenzuar paraqet rrezik për shpenzime të parregullta dhe vlerë të dobët për para. Kjo rritë rrezikun që paratë publike të shpenzohen në mënyrë jo racionale.

**Rekomandimi 10** Kryetari i Komunës të siguroj se ekzistojnë kontrole të duhura për shpenzimet e drekeve zyrtare, me theks të veçantë këtyre shpenzimeve duhet t'iu paraprij një proces i aprovimit që kërkon dëshmi të duhura dhe të mjaftueshme për të demonstruar qëllimin dhe koston e këtyre organizimeve.

### Çështja 11. Shpenzim pa kontratë adekuate -Prioriteti - I mesëm

**E gjetura** Komuna kishte paguar shumën prej 10,000€ për transportin e lojtarëve të klubit "Drita". Kjo pagesë ishte bërë duke shfrytëzuar kontratën për transportin e nxënësve dhe punëtorëve të komunës.

**Rreziku** Pagesat e tilla duke përdorur një kontratë jo adekuate paraqet rrezik që mjetet publike të shpenzohen në mënyrë jo racionale.

**Rekomandimi 11** Kryetari i Komunës duhet të siguroj që fillimisht të zhvillohen procedurat e prokurimit dhe pastaj të bëhen pagesat për kryerjen e shërbimeve duke u bazuar në kontratat valide.

### 4.5.3 Kompensimet ( pagat dhe mëditjet)

#### Përshkrimi

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar (payrollit). Kontrollat që operojnë në nivel lokal nga komuna kanë të bëjnë me a) kontrollin i pagesave çdo muaj duke i nënshkruar listat e pagave b) verifikimin e ndryshimeve të mundshme që mund të paraqiten përmes formularëve, c) rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimet me thesarin.

Për këtë kategori testuam 60 njësi mostre ku rishikuam pajtueshmërinë e listave të pagave me sistemin e payrollit në MAP. Po ashtu, kemi shikuar nëse pozitat e zyrtarëve dhe koeficientet janë në pajtueshmëri me formën e sistemit të payrollit dhe listës së pagave dhe teste tjera relevante për t'i adresuar të gjitha pohimet. Ne konstatuam se çështjet e cekura janë në pajtim me kërkesat ligjore. Testet tona në këtë kategori kanë identifikuar disa çështje në vijim:

---

#### Çështja 12. Pranimi i punëtorëve pa konkurs publik dhe tejkallim numrit të punëtorëve të lejuar - Prioritet i mesëm

**E gjetura** Drejtoria e Arsimit kishte punësuar 30 punëtorë si zëvendësues të punëtorëve në pushime të lehonisë dhe pushime pa pagesë, pa shpallur konkurs publik. Sipas zyrtarëve, kjo është bërë për të lehtësuar procesin e rekrutimit.

Po ashtu, drejtoria e administratës kishte pranuar gjashtë punonjës më tepër se sa ishin të planifikuar.

**Rreziku** Pranimi i punëtorëve pa konkurs publik paraqet mosrespektim të parimit të konkurrencës barabartë. Kjo mund rezultojë me pranim të stafit jo të duhur. Pranimi i punëtorëve jashtë listës së pagave duke tejkalluar numrin e lejuar, rritë rrezikun që të krijohen obligime financiare përtej fondeve në dispozicion.

**Rekomandimi 12** Kryetari i komunës duhet të rishikoj arsyet pse rregulloret nuk janë ndjekur në këtë fushë dhe të siguroj që kontrole të duhura zbatohen për t'u siguruar që rekrutimet e ardhshme bëhen në përputhshmëri me ligjet relevante.

## 4.5.4 Subvencionet dhe Transferet

### Përshkrimi

Subvencionet janë fonde të cilët ndahen nga Kryetari dhe Kuvendi Komunal për të mbështetur grupe të caktuara të interesit, si në sport, kulturë, edukim dhe aktivitete tjera.

---

### Çështja 13. Mosrespektim i rregullores së brendshme - Prioritet i lartë

**E gjetura** Në nëntë (9) raste të subvencionimit, shumat e ndara tejkalonin limitin e përcaktuar nga rregullorja e brendshme. Sipas kësaj, kryetari aprovon subvencione për persona juridik deri në 2,000€ ndërsa për persona fizik deri në 1,200€. Për çdo shumë më të lartë, mjetet duhet të ndahen nga Komiteti për Politikë dhe Financa i Kuvendit Komunal. Limiti i shumës së lejuar nuk ishte respektuar nga kryetari.

Informacionet e ofruara nga përfituesit qoftë gjatë fazës së aplikimit, por edhe pasi fondet ishin ndarë ishin të mangëta. Kryesisht mungonin projekt propozimet, kërkesat, dhe raportet kthyesë nga përfituesit për mënyrën e shpenzimit të fondeve.

**Rreziku** Mungesa e raporteve kthyesë i pa mundëson komunës të përcjellin nëse fondet po përdoren për qëllimet e synuara (objektiva të caktuara). Tejkalimi i limitit të lejuar nga kryetari është në kundërshtim me rregulloren e brendshme për dhënien e subvencioneve.

**Rekomandimi 13** Kryetari i komunës të siguroj se procesi i subvencionimit të zhvillohet në përputhje me rregulloren e aprovuar dhe që të ketë një monitorim më të afërt për mënyrën e shpenzimit të subvencioneve.



## 4.6 Pasuritë dhe detyrimet

### 4.6.1 Pasuritë kapitale dhe jo kapitale

#### Përshkrim

Të gjitha çështjet që lidhen me pasuritë kapitale janë shpjeguar në seksionin 2.2 Rreziqet domethënëse në PVF.

### 4.6.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve

#### Përshkrim

Komuna në vitin 2013 kishte paraqitur në PVF llogaritë e arkëtueshme në shumë prej 9.7 milion euro. Kjo shumë kishte rezultuar nga faturimet që ka bërë komuna ndaj qytetareve, bizneseve etj. në vitet paraprake.

---

#### Çështja 14. Rritja e llogarive të arkëtueshme- Prioritet i lartë

**E gjetura** Komuna nuk kishte marrë masa konkrete për të mbledhur llogaritë e arkëtueshme të vitit 2013 dhe ato të mëhershme. Gjendja e këtyre llogarive në fund të vitit 2013 ishte 9,714,617€ krahasuar me vitin 2012 që ishte 9,008,470€, ku pjesa dërmuese e këtyre llogarive përfshin borxhin nga tatimi në pronë.

**Rreziku** Rritja e nivelit të llogarive të arkëtueshme e pamundëson aftësinë e komunës për të realizuar projektet kapitale të cilat planifikohen të financohen nga të hyrat vetjake. Ekziston rreziku që mungesa e veprimeve për të mbledhur të hyrat, inkurajon qytetarët të mos paguajnë borxhet e tyre.

**Rekomandimi 14** Kryetari i Komunës të rishikoj mundësinë e zvogëlimit të llogarive arkëtueshme në mënyrë që të financoj projektet kapitale të komunës si dhe të hartoj një plan veprimi për mbledhjen e borxheve.

## 4.7 Trajtimi i borxheve

### Përshkrim

Pasqyra e detyrimeve financiare të papaguara sipas faturave ndaj furnizuesve në fund të vitit 2013 ishte 4,112,627€, cilat janë bartur për t'u paguar në vitin 2014. Përveç kësaj, komuna ka raportuar edhe 2,903,510€ detyrime kontingjente.

---

### Çështja 15. Hyrje në obligime përtej buxhetit të aprovuar - Prioritet i lartë

**E gjetura** Komuna kishte hyrë në obligime më shumë se ndarjet buxhetore. Ne do t'i përmendim tri kategori me ndikim më të madh.

Fondi i ndarë për shërbime komunale për vitin 2013 ishte 531,580€, ndërsa ishin shpenzuar 466,999€, ndërsa obligimet e pa paguara për këtë kategori në fund të vitit 2013 ishin 200,280€. Hyrja në obligime për këtë kategori përtej buxhetit ishte 135,699€.

Fondi i ndarë për kategorinë e mallrave dhe shërbime për vitin 2013 ishte 3,227,704€, ndërsa ishin shpenzuar 3,128,543€ apo 97%. Obligimet e pa paguara për këtë kategori në fund të vitit 2013 ishin 1,211,290€. Hyrja në obligime për këtë kategori përtej buxhetit ishte 1,112,129€.

Buxheti i ndarë për kategorinë e investimeve kapitale ishte 5,334,859€, ndërsa ishin shpenzuar 4,826,165€. Obligimet e mbetura në fund të vitit 2013 për kapitale sipas faturave ishin 2,485,040€. Obligimet e krijuara përtej buxhetit të lejuar ishin 1,976,346€. Nga kjo mund të konkludojmë se komuna nuk i kishte menaxhuar drejt obligimet e papaguara dhe kjo ka shkaktuar një rritje të pa kontrolluar në fund të vitit.

**Rreziku** Komuna ka menaxhuar dobët me buxhetin, duke krijuar obligime të shumta që duhen paguar në vitin 2014. Kjo rritë rrezikun që planet e ardhshme të shpenzimeve të mos arrihen për shkak të nevojës për të paguar obligimet e viteve paraprake. Hyrja në obligime përtej ndarjeve buxhetore mund ta sjellë komunën në vështirësi financiare dhe me mundësinë potenciale për hapjen e kontesteve gjyqësore. Kjo sjellë në pikëpyetje serioze edhe realizimin e projekteve të parapara.

**Rekomandimi 15** Kryetari i Komunës duhet të rishikoj çështjen e obligimeve të pa paguara duke diskutuar me të gjitha nivelet (MF-në dhe Qeverinë) si dhe të krijoj një strategji adekuate për të menaxhuar dhe mbajtur nën kontroll obligimet.

## 4.8 Sistemi i auditimit të brendshëm

### Përshkrimi

Sistemi i auditimit të brendshëm është një pjesë kyçe e kontrollit të brendshëm. Ne e marrim parasysh fushëveprimin e punës së auditimit të brendshëm dhe aktivitetet e Komitetit të Auditimit. Mund të thuhet se Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) kishte arritur ta realizoj planin vjetor të auditimit, ku kishte mbuluar fushat me rrezik të lartë. NJAB-i kishte përgatitë raporte tre mujore, të cilat i kishte dërguar edhe në Njësinë Qendrore Harmonizuese në Ministri të Financave. Raportet e auditimit të brendshëm ishin të një cilësie të mirë.

Komiteti i Auditimit kishte mbajtur katër takime, ku kishte diskutuar raportet e Njesisë së Auditimit të Brendshëm.

---

### Çështja 16. Auditimi i brendshëm - Prioritet i mesëm

**E gjetura** NJAB kishte kryer 10 nga 11 raportet e auditimeve të planifikuara. Katër raportet e auditimit janë të ndërlidhur me aktivitetet e vitit 2012 derisa raportet tjera përfshijnë vitin 2013. Kjo ka ndodhur për shkak të aktivitetit të ulët në fillim të vitit tek drejtoritë që kanë qenë objekt i auditimit.

Komiteti i auditimit të brendshëm edhe pse kishte mbajtur takime të rregullta, nuk i kishte ngritur të gjeturat e auditimit të brendshëm tek menaxhmenti për tu siguruar që ato do të adresohen.

**Rreziku** Kryerja e auditimeve me fokus vitin paraprak, nuk ofron siguri të mjaftueshme menaxhmentit lidhur me funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm si dhe rritë rrezikun që kontrollet e brendshme të mos jenë efektive. Mungesa e diskutimit e të gjeturave në mes menaxhmentit dhe komitetit të auditimit lidhur me fushëveprimin e auditimit të brendshëm ndikon që efektiviteti i kontrollit të brendshëm të mos përmirësohet.

**Rekomandimi 16** Kryetari duhet të sigurojë se aktiviteti i ardhshëm i AB-së të orientohet në auditimet vitit aktual në mënyrë që t'i ofroj menaxhmentit siguri të vazhdueshme për sa i përket efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm për të gjitha rrjedhat e të hyrave dhe shpenzimeve domethënëse. Për më tepër, Komiteti i auditimit duhet të bëjë një plan pune ku do t'i specifikoj agjendat e punës dhe çështjet që do t'i trajtoj gjatë vitit në mënyrë që të përmirësoj funksionimin e kontrollit të brendshëm.

---

## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar nëse** arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornizë për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

*Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit*

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk përhapen në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare mund të jenë materiale por nuk përhapen.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe përhapen në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare mund të jenë edhe materiale edhe të përhapen. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705<sup>19</sup> jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
2. Pasqyrat Financiare	PVF të jenë të plota te përfshijnë të gjitha shpalosjet bazuar në rregullën financiare në fund vit.		PO	
3.Rekomandimet e vitit paraprak	Kryetari duhet të sigurojë që plani i veprimit i rishikuar në mënyrë të qartë përcakton një afat kohor dhe stafin përgjegjës për adresimin e rekomandimeve.	PO		
4.3 Kërkesat e raportimit	Kryetari duhet të sigurojë që i gjithë stafi përgjegjës për MFK-në të përmbushë kërkesat e Procedurës së MFK-së për Vetëvlerësim.	PO		
4.4 Te hyrat	Kryetari duhet të analizojë në mënyrë gjithëpërfshirëse gjendjen e të hyrave, si: arsyet e mos pagesave, vjetërsia e borxheve.			JO
4.4 Te hyrat	Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha mjetet e mbledhura nga participimet deri në 10€, të depozitohen brenda afatit të përcaktuar.		PO	

4.5.1 Shpenzimet	Kryetari duhet të sigurojë që kontratat të mos nënshkruhen para zotimit të plotë të fondeve.		PO	
4.5.1	Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha projektet kapitale realizohen në përputhje të plotë me planifikimin. Çdo ndryshim ndërmjet ndarjeve për projekte duhet të pasqyrohet në PIP dhe të aprovohet nga MF-ja.		PO	
4.5.1	Kryetari duhet të sigurojë që punët kapitale të përfundojnë brenda afateve optimale dhe objektivisht të arritshme.			JO
4.5.1	Kryetari duhet të sigurojë që sa më parë të anulohet vendimi për kompensimin e mbikëqyrjes dhe pranimit teknik të punëve përmes operatorëve ekonomik.			JO
4.5.1	Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha shpenzimet të bëhen sipas natyrës përkatëse në përputhje me kërkesat e LMFP-së dhe Ligjit të Buxhetit.	PO		
4.5.1	Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme dhe të sigurojë që të gjitha shpenzimet të bëhen brenda limiteve të përcaktuara me kontratë.		PO	
4.5.1	Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha faturat për dreka zyrtare të mbështeten me dëshmi shtesë si nr. pjesëmarrësve.			JO



4.5.2 Pagat	Kryetari duhet të zgjidhë këtë jo konsistencë, dhe të përcaktojë nëse këto janë vetëm raste të izoluar apo janë dukuri e përhapur. Varësisht nga gjendja, të forcohen edhe kontrollet për të parandaluar praktikatat e tilla			JO
4.6 Subvencionet dhe Transferet	Kryetari duhet të sigurojë që të respektohet Rregullorja e brendshme për ndarjen e subvencioneve dhe të gjitha subvencionet trajtohen sipas procedurave të përcaktuara në rregullore.		PO	
4.6	Kryetari duhet të sigurojë që subvencionet ndahen kur aplikuesi paraqet projekt të detajuar ku qartësohet interesi i komunës. Po ashtu, duhet bërë marrëveshje me të gjithë përfituesit duke i obliguar për mënyrën e shpenzimit dhe raportimit.			JO
4.6	Kryetari duhet të sigurojë që nuk do të përsëriten rastet që paraqesin konflikt interesi.	PO		
4.6.1	Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha pasuritë mbi 1,000€ të regjistrohen në SIMFK brenda një afati të caktuar		PO	
4.7 Trajtimi i Borxheve	Kryetari të përpilojë një strategji të qartë për mënyrën e shlyerjes së obligimeve të papaguara dhe nxjerrjes së komunës nga kjo gjendje e borxheve.			JO